VENDIM
Nr.313, datë 5.5.2010

PËR NJË SHTESË FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË PIKËS SË KALIMIT KUFITAR QAFËBOTË DHE TË DISA PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE, TË KONTRAKTUARA E TË PALIKUIDUARA NGA VITI 2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t'i shtohet fondi prej 103 339 000 (njëqind e tre milionë e treqind e tridhjetë e nëntë mijë) lekësh, për vazhdimin e ecurisë dhe ndërhyrjet emergjente, në projektet e poshtëshënuara:

a) Projekti për ndërtimin e pikës së kalimit të kufirit Qafëbotë;

b) Projekte të investimeve të kontraktuara dhe të palikuiduara nga vitit 2009.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha